

VENDIM
Nr. 298, datë 23.5.2018

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË THESARIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 7, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit si person juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për financat, me seli në Tiranë.

2. Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit është sigurimi dhe realizimi i shërbimeve operacionale për qeverisjen e përgjithshme, që garanton paranë e gatshme për kryerjen e transaksioneve të pagesave.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit financohet nga buxheti i shtetit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit ka shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit”. Degët e thesarit kanë stemat, logot dhe vulat e tyre zyrtare. Stema e secilës degë thesari ka shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Dega e Thesarit...”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës.

5. Vula e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe vula e secilës degë thesari ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka këto funksione dhe përgjegjësi kryesore:

a) Menaxhimin e mjeteve monetare për kryerjen e pagesave brenda kufijve të limitit të *cash*-it;

b) Kryerjen e pagesave në mënyrë të centralizuar dhe administrimin funksional të sistemit informatik financiar të qeverisë, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, për procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit dhe të raportimit financiar;

c) Regjistrimin, kontrollin, kontabilizimin dhe përpunimin e informacionit të transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme;

ç) Llogaritjen e vlerës për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë në mënyrë proporcionale dhe sipas radhës së numrit të pagesave;

d) Menaxhimin e procesit të shpërndarjes së dëmshpërblimit financiar të ish-të dënuarve politikë me transparencë dhe në kohë;

dh) Hartimin e akteve nënligjore, të cilat prekin fushën e përgjegjësisë së institucionit dhe i propozohen ministrit përgjegjës për financat.

7. Detyrat kryesore të degëve të thesarit janë:

a) Përmirësimi i kontrollit financiar;

b) Regjistrimi, dokumentimi, rakordimi dhe raportimi i realizimit të treguesve buxhetorë dhe i pasqyrave financiare të njëjshve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme;

c) Përmirësimi i menaxhimit të likuiditetit.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit organizohet në nivel qendror, nëpërmjet zyrës qendrore, si dhe në nivel vendor, nëpërmjet degëve të thesarit. Degët e thesarit në nivel vendor, në

përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, krijohen me urdhrin e Kryeministrit për miratimin e organizimit të brendshëm të kësaj drejtorie, pas propozimit të ministrit.

9. Organizimi i brendshëm, struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet para ministrit.

11. Degët territoriale drejtohen nga titullari i degës, i cili raporton te drejtori i përgjithshëm.

12. Marrëdhëniet e punës të drejtorit të Përgjithshëm, të nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe të degëve të saj rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

13. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit miratohet nga ministri përgjegjës për financat, me propozimin e titullarit të institucionit.

14. Për nëpunësit civilë aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe degëve të saj zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

15. Deri në fillimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, sipas këtij vendimi, struktura ekzistuese vazhdon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës së miratuar.

16. Ministri përgjegjës për financat, brenda një muaji, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përgatit dhe propozon strukturën dhe organikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

17. Numri i punonjësve dhe fondet e miratuara për Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe për degët e thesarit kalojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit sipas këtij vendimi.

18. Vendimi nr. 183, datë 16.4.1993, i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të thesarit”, shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama